



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 1545 prot.

Tiranë, më 29 . 09 .2025

VENDIM

Nr. 6 , Datë 29 / 09 /2025

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (PERSONEL AKADEMIK), PËR
ZGJEDHJEN E AUTORITETEVE DREJTUESE TË NJËSIVE BAZË KANTO DHE
SKULPTURË, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve”, të miratuar me Vendimin nr. 17 datë 29.03.2024 të Senatit Akademik të UART, si dhe të Urdhrit nr. 107, datë 01.09.2025 të Rektorit të Universitetit të Arteve “Për marrjen e masave për zhvillimin e procesit zgjedhor, caktimin e datës së fillimit të procesit zgjedhor dhe të datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Përgjegjës të Njësive Bazë KMDP, Kanto dhe Skulpturë në Universitetin e Arteve”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Arteve, në mbledhjen e datës 29 . 09 .2025, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e trupës zgjedhore nga kategoria “Personel akademik” të Njësive Bazë Kanto, në Fakultetin e Muzikës, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Miratimin e trupës zgjedhore nga kategoria “Personel akademik” të Njësive Bazë Skulpturë, në Fakultetin e Arteve të Bukura, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ky vendim të dërgohet pranë Komisioneve Zgjedhore të Fakulteteve të Universitetit të Arteve, të cilat kanë për detyrë të afishojnë listat përfundimtare në ambientet e dedikuara të secilit Fakultet.
4. Ky vendim të publikohet në faqen elektronike të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Orges Malaj

Kryetar



Shpëtim Kërçova

Anëtar

Redjan Mulla

Sekretar

Suela Agolli

Anëtar

Adela Kusuri

Anëtar

Sara Caca

Anëtar